



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 48, datë 19.11.2021

PËR
AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
BACHELOR NË “HISTORI GJEOGRAFI”, TË UNIVERSITETIT “ISMAIL QEMALI”,
VLORË

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksonimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 11.9.2018, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 19.11.2021, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në “**Histori Gjeografi**”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Bachelor në “**Histori Gjeografi**”
- b) Cikli i studimit: Cikli i parë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 270, datë 10.06.2011
- d) Institucioni që e ofron: Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë
- e) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Edukimit
- f) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 3 vite / 6 semestra
- g) Kredite (ECTS): 180 kredite
- h) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- i) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë
- j) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 6

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Raportimin e Ekspertëve të Vlerësimit në mbledhjen e Bordit;
- e. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- f. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- g. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuar përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimin të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”* dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit është **“i përmbush pjesërisht standardet”**, me mangësitë si më poshtë:
 1. Mungon një studim i mirëfilltë i tregut të punës, në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.
 2. Mungesa e teksteve bazë për këtë program studimi si dhe e literaturës bashkëkohore, në bibliotekë.
 3. Përfshirje minimale e stafit akademik të këtij programi studimi, në projekte shkencore vendase dhe ndërkombëtare, si dhe numër relativisht i vogël i publikimeve shkencore, të botuara në revista ndërkombëtare të indeksuara.
 4. Mungesa e një laboratorit IT me GIS software, për krijimin e hartave digjitale.
 5. Mungesa e diversifikimit të mekanizmave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, sikurse parashikohet në Statutin e institucionit

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit **Bachelor** në **“Histori Gjeografi”**, të **Universitetit “Ismail Qemali”**, Vlorë, me rekomandimet sipas shtojcës së këtij vendimi.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **3 (tre)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **30/09/2024**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT


SHQIPONJA TELHAJ		Kryetare
ALEXANDER KOHLER		Anëtar
AYŞEN SAVAŞ SARGIN		Anëtar
TOMASZ JELENSKI		Anëtar
IRAJ HASHI		Anëtar
MAURICE OUDEJANS		Anëtar
LEA YPI		Anëtar
KITA SALLABANDA DIAZ		Anëtar
DARINKA PIQANI		Anëtar

DRITAN NAÇE



Anëtar

INDRIT HOXHA



Anëtar

Shënim: Znj. Lea Ypi nuk mori pjesë në këtë mbledhje.

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 48, datë 19.11.2021, “Për akreditimin e parë të programit të studimit **Bachelor në “Histori Gjeografi”**”, të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, janë si vijon:

1. Institucioni, të kryejë një studim të tregut të punës për të kuptuar kërkesat e kohës, trendet dhe perspektivën e punësimit që ka lidhje me këtë program studimi si dhe të reflektohen gjetjet e këtij studimi në programin e studimit.
2. Institucioni, të pasurojë bibliotekën e institucionit, duke siguruar kopje të teksteve bazë dhe të literaturës bashkëkohore, për këtë program studimi.
3. Institucioni, të marrë masa për rritjen e përfshirjes së stafit akademik të këtij programi studimi në projekte shkencore vendase dhe ndërkombëtare, si dhe rritjen e publikimeve shkencore, të botuara në revista ndërkombëtare të indeksuara.
4. Institucioni, të marrë masa për krijimin e një laboratorit IT, me GIS software, për hartografinë digjitale.
5. Institucioni, të diversifikojë mekanizmat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, duke ngritur komisionin e përhershëm të sigurimit të cilësisë, sikurse parashikohet në Statutin e tij.
6. Institucioni, të rrisë promocionin për këtë program studimi nëpërmjet një fushate informuese dhe sensibilizuese për afrimin e studentëve. Të azhurnohet gradualisht programi i studimit “Histori-Gjeografi” në drejtim të kurrikulave me tendencën e përgatitjes së specialistëve që kërkon tregu i punës si dhe të realizohet ekuivalentimi ose përafrimi i programit mësimor me programe të ngjashme të huaja.
7. Institucioni, të marrë masa për rritjen e numrit të mobiliteteve të studentëve dhe stafit akademik.
8. Institucioni, të pasurojë / përditësojë faqen e tij të internetit, me informacion të detajuar për këtë program studimi, duke përfshirë syllabuset, në gjuhën shqipe dhe atë angleze, në mënyrë që studentët apo kandidatët për studentë të informohen edhe në distancë.
9. Institucioni, të nënshkruaj një marrëveshje me AADF (Fondin Shqiptar Amerikan të Zhvillimit) për të bërë të mundur implementimin e Clean Score për provimet, e cila do të ndihmojë në rritjen e transparencës dhe përmirësimin e sistemit të sigurimit të cilësisë.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

